Marrëdhënet me fqinjët dhe puna që Dhoma Amerikane ka filluar në bashkëpunim me homologët, për të krijuar një bashkëpunim të ngushtë rajonal, ka qenë gjithashtu në qendër të diskutimeve. Njohuritë e z. Banks për rajonin, si një zonë me të cilën ai është i familjarizuar kanë zgjuar interesin për projektet që janë në diskutim. Presidenti i AmCham-it është dalluar më shumë në Konferencën rajonale të organizuar në Tiranë dhe obejktivat që la për të ardhmen kjo konferencë. Ndërkohë, rajoni ka edhe një tjetër bashkëpunim në nivel qeveritar të prezantuar nga Ministrat e Ekonomisë, për nëshkrimin e strategjisë së përbashkët deri në 2020-ën për zhvillimin e rajonit.

Të para në këndvështrimin e punës së përbashkët që duhet të bëjnë Dhomat, Znj. Floreta Luli-Faber i ka folur edhe për mundësinë e "trokitjes në derë" në Uashington të përfaqësuesve të rajonit për të bërë të mundur prezantimin dinjitoz të një tregu rajonal. Ideja e diskutuar gjatë Konferencës rajonale do të zërë vend në axhendën e vitit në vazhdim dhe Dhomat Amerikane në rajon do të punojnë për të bërë një prezantim dinjitoz të risurseve dhe mundësive që ofron çdo vend në veçanti dhe të gjithë bashkë si treg tek investitorët amerikanë.

Gjatë takimit, është folur edhe për mundësitë e ndihmës së qeverisë Amerikane nëpërmjet projekte të zhvillimit dhe z. Banks ka shpjeguar se mundësitë janë të limituara sepse kërkesat sot për zhvillimin e vendeve janë globale dhe Shqipëria është pjesë e këtyre kërkesave, për të cilat qeveria Amerikane përgjigjet brenda mundësive që ka.

Gjithnjë në kuadrin e ndihmës që autoritetet Amerikane mund të japin për tërheqjen e investimeve të huaja dhe shkëmbimeve të informacionit, Floreta Luli-Faber ka kërkuar një bashkëpunim më të ngushtë me Ambasadën për ndihmë logjistike gjatë kohës kur organizohen grupe pune për Misione Tregtare në Panairet e mbështetura nga Departamenti i Komercit në Uashington. Korrupsioni dhe transaprenca qeveritare në perceptimin e njerëzve që merren me biznes, ka qenë gjithashtu një çështje e diskutueshme, për të cilën anëtarët e bordit kanë dhënë mendimin e tyre. Një vullnet pozitiv i qeverisë për të luftuar korrupsionin dhe për të ndihmuar biznesin që të ketë një klimë më të qëndrueshme është mirëpritur nga biznesi, i cili po pret rezultatet e këtij qëndrimi.

# WoBAC committee makes working visit to Gjakova

**The AmCham Women in Business Activity Committee, WoBAC, held a business meeting in Gjakova, where it met with Mimoza Kusari, who was running for mayor of the city. They spoke about the opportunities provided to women in politics and business and what they must do to promote successful images of women leaders.**

Ms. Kusari's example shows that a leader can move from an experience in business – she is a former AmCham Kosovo executive director – to both local and national politics. Ms. Kusari has become a household name not only in Kosovo but in Albania as well, which drove WoBAC members to set up a working lunch with her while visiting Kosovo.

Also participating in the meeting were many women from Gjakova who are involved and active in the business world and politics, creating a group that could assist in increasing awareness on the need of strengthening the role of women in the society of both countries, which share a common language and national heritage.

"There is a big resistance in society to not allow women in leadership positions but we have shown that when we decide to do a good job, we know how to do it," said Ms. Kusari.

Referring to her career, Ms. Kusari said a lot of work was needed to get to where she is today but she had aimed to always implement policies that supported to role of women in in all sectors where she had been a leader. Speaking about the same objectives, included in WoBAC's agenda, the head of the committee, Flutra Veipi, spoke about what the chamber is implementing through a detailed plan to promote the work of its female members who are successful in business and are equally involved and valued the in social and political life of the country. That's a major objective for WoBAC.

Representatives from Albania introduced themselves and brought their views on broad cooperation that should exist between women everywhere.

> "Historia jonë jo gjithmonë ka qenë e lehtë dhe ka patur diversitetin e saj " **– ka thënë gjatë fjalës së tij z. Mark Crawford, President i Dhomës Amerikane,**

In a sign of respect for the work that Ms. Kusari has been doing, AmCham's Ardiana Shehi donated a book with quotes on compromise. It wasn't the only book gift for Ms. Kusari. The representative also donated a book with works of her studio while another AmCham member donated a book about her work as an cosmetician in Albania.

"I am happy that you have valued my work and brought as gifts books that you have worked on yourself," said Ms. Kusari.

The WoBAC delegation also visited the neighboring city of Prizren.










> "Historia jonë jo gjithmonë ka qenë e lehtë dhe ka patur diversitetin e saj " **– ka thënë gjatë fjalës së tij z. Mark Crawford, President i Dhomës Amerikane,**

# Komiteti WoBAC vizitë pune në Gjakovë

**Komiteti Aktiv i Grave në Biznes ka patur një takim pune në Gjakovë, ku ka diskutuar me kandidaten për kryetare të Bashkisë së Gjakovës, Mimoza Kusari, shanset e integrimit të gruas në politikë dhe punën që duhet të bëjë një organizatë për të promovuar figurat e njohura të grave në biznes.**

Shembulli i Mimoza Kusarit, e cila nga një drejtuese e një organizate biznesi si AmCham-i u përfshi në politikën lokale e më pas në atë shtetërore dhe spikati si një emër i njohur jo vetëm në politikë, por edhe në shqipëri, ka bërë që anëtaret e WoBAC-ut të oganizojnë një drekë pune me të.

Takimi ka patur edhe prezencën e shumë grave nga Gjakova, të cilat kanë mundur të realizojnë në jetën e tyre një arritje në biznes, në shoqëri apo edhe në politikë, duke krijuar kështu një grupim që sa vjen e bëhet më i fortë dhe sensibilizon shoqëritë e të dy vendeve për të respektuar zërin e gruas.

"Ka një rezistencë të madhe në shoqëri për të mos e lënë një grua të jetë drejtuese, por ne kemi treguar se kur vendosim të bëjmë një punë, dimë ta bëjmë mire" - tha znj. Kusari në fjalën e saj. Duke iu referuar karrierës së saj, znj. Kusari tregoi se i ishte dashur shumë mund e punë për të arritur këtu, por e kishte patur vëmendjen të aplikonte në punën e saj politika të përkrahjes dhe integrimit të gruas në gjithë sektorët që kishte drejtuar.

Duke folur për të njëjtin objektiv në të cilin është përfshirë edhe Komiteti Aktiv i Grave në Biznes, kryetarja e këtij Komiteti, znj. Flutura Veipi, ka treguar se Dhoma është duke zbatuar një plan të detajuar pune për të promovuar anëtaret e saj, që siç janë të suksesshme në biznes, të jenë po aq të përfshira dhe të vlerësuara edhe në jetën shoqërore dhe politike të vendit. Ky është dhe objektivi madhor i Komitetit të WoBAC-ut. Përfaqësueset nga Shqipëria, duke prezantuar vetveten kanë sjellë mendimet e tyre mbi bashkëpunimin e gjerë që duhet të ekzistojë mes grave kudo që janë. Në shenjë respekti për punën që Mimoza ka bërë me jetën e saj dhe ndihmën që jep për këtë qëllim, znj. Ardiana Shehi i ka dhuruar një libër me citate për kompromisin. Ky nuk ka qenë i vetmi libër dhuratë për Mimoza Kusarin. Përfaqësuesja e Studios Cubi i ka dhuruar një libër me punime të studios së saj ndërkohë që, një prej anëtareve të Dhomës ka patur dëshirën t'i dhurojë një libër mbi punën e saj si estetiste në Shqipëri.

"Jam e lumtur që ju më keni vlerësuar dhe më sollët dhuratë libra të cilët i keni punuar vetë" - ka thënë znj. Kusari. Vizita në Gjakovë ka pasuar me një tjetër vizitë në Prizren.



# Marching
## against breast cancer
### *AmCham becomes part of the initiative*

**A march against breast cancer filled Tirana's main boulevard with hundreds of women and girls as well as men and boys in solidarity to increase public awareness of the vital importance of working to prevent this disease.**

The march started at Mother Teresa Square to proceed down the Nation's Fallen Boulevard to the National Gallery of Art.

Present at the event, U.S. Ambassador Alexander Arvizu said in his speech that science has made advances against this deadly with early detection and treatments that fight it.

"We know that with breast cancer and other types of cancer, that although people may develop healthy lifestyles, there is something called DNA. All are the product of our parents, and there are some people who are more at risk of exposure to breast cancer due to their parents' genetics and family history," said the ambassador.

According to Ambassador Arvizu, this is why early detection through regular checkups is absolutely vital, because if someone finds the disease early, more appropriate treatments exist that can help in its treatment.

During the activity aimed to increase awareness, YWCA volunteers distributed informational materials on ways of detecting breast cancer early.

The march was the closing event of the one-month campaign to inform and raise the awareness among women and girls to prevent breast cancer.

Globally, every 75 seconds a woman dies from breast cancer, despite the fact that this is a completely treatable disease if caught early.

As part of this campaign, during the month of October, an ambulance was made available to some of the country's poorest women. Inside the vehicle women were able to do breast checks and, they received vouchers for free mammograms.

The American Chamber of Commerce in Albania and its WoBAC committee also expressed solidarity with organizers and became part of this initiative that directly serves women and their wellbeing.





# Marshimi
## kundër Kancerit të gjirit
### *Dhoma Amerikane bëhet pjesë e iniciativës*

**Marshimi kundër kancerit të gjirit ka mbledhur në bulevard me qindra gra, por edhe burra që janë solidarizuar në një ditë si kjo, për të sensibilizuar shoqërinë për rëndësinë jetike që ka puna për parandalimin e kësaj sëmundjeje. Marshimi nisi nga sheshi "Nënë Tereza" për të vazhduar më tej në bulevardin "Dëshmorët e Kombit" drejt Galerisë Kombëtare të Arteve.**

I pranishëm në këtë aktivitet, Ambasadori Amerikan z. Aleksandër Arvizu gjatë fjalës së tij u shpreh se kundër kësaj sëmundjeje që të vret, shkenca ka mundur të zbulojë trajtime dhe kurimeve që e luftojnë atë. "E dimë që me kancerin e gjirit dhe me çfarëdo lloj tjetër kanceri, që ndonëse njerëzit mund të zhvillojnë stilin më të shëndetshëm të mundshëm të jetesës, ka diçka që quhet ADN. Të gjithë jemi produkt i prindërve tanë, dhe ka disa njerëz që janë më shumë në rrezikshmëri të ekspozimit të kancerit të gjirit, për shkak të gjenetikës së prindërve të tyre dhe historisë familjare", u shpreh Ambasadori.

Sipas Ambasadorit Arvizu, kjo është arsyeja se përse kontrollet e hershme janë absolutisht jetike, sepse nëse qëllon që kjo sëmundje godet dikë, sa më herët që mund të dallohet aq më shumë ekzistojnë trajtime të duhura që mund të ndihmojnë në kurimin e kësaj sëmundjeje. Gjatë këtij aktiviteti sensibilizues, vullnetarët e YWCA-s, shpërndanë materiale informuese për mënyrat e zbulimit të hershëm të kancerit të gjirit. Marshimi është aktiviteti përmbyllës i të gjithë fushatës një-mujore për informimin dhe ndërgjegjësimin e grave e të vajzave për parandalimin e kancerit të gjirit. Në botë, çdo 75 sekonda një grua humb jetën pas prekjes nga kanceri i gjirit ndërkohë që, kjo është një sëmundje tërësisht e shërueshme nëse kapet në stadin e parë të saj. Si pjesë e kësaj fushate, gjatë muajit tetor është vënë në dispozicion të grave të shtresave më të varfëra një autoambulancë, në mjediset e brendshme të së cilës gratë kishin mundësi të bënin kontrolle të gjirit dhe në raste nevoje, dhe të merrnin kupona për mamografi falas.

Dhoma Amerikane e Tregtisë dhe Komiteti i Gruas në këtë organizatë u solidarizuan dhe u bënë pjesë e kësaj iniciative, që i shërben drejtpërdrejt grave dhe mirëqenies së tyre.

# Member News

SIGAL

The Albanian-American Enterprise Fund (AAEF) is the first foreign investor in the Albanian insurance market. It entered a time when the market was newly-formed and still in its first steps -- 10 years ago. The cooperation agreement which AAEF and SIGAL signed ten years ago marked an important milestone for all of the insurance market, not just for the AAEF and SIGAL as shareholders. On the occasion of the 10th anniversary of this agreement, the AAEF Board held a meeting and a press conference at the offices of SIGAL UNIQA.

In his address, SIGAL UNIQA CEO Avni Ponari thanked AAEF for the support and confidence shown and listed some of the achievements of SIGAL UNIQA over the past 10 years.Thanks to the support of AAEF, SIGAL was transformed from a local company into the largest regional insurance group consisting of 8 companies. Very good financial performance and support of AAEF led to the entry of a strategic investor in the insurance field in 2007 through cooperation with UNIQA Group which is currently the largest shareholder of SIGAL UNIQA. UNIQA Group Austria is one of the strongest financial institutions in Central-East Europe, evaluated with 'A' from Standard & Poor's and present in 21 countries.

Part of UNIQA's plans and challenges for the near future involve investing in other strategic sectors in Albania in addition to insurance.In his speech, AAEF President Michael Granoff, among other things, said:"We are proud to be part of this company and this partnership. This investment is a success story because we have entered the insurance market to change it and in 10 years have done so with SIGAL."

The example speaks for itself because just a few offices have turned into hundreds and a few employees have become several thousand. Along with SIGAL, AAEF has contributed to develop the insurance sector, he added. SIGAL now aims to transform into a leading company in this region because the insurance market is a market with tremendous potential. Thanks to investments by AAEF and UNIQA, two important strategic partners, SIGAL UNIQA Group has created more confidence for customers and the insurance market as a whole, not only in Albania but throughout the region, aiming to have the insurance industry take its place as one of the main three main pillars of development of each country. SIGAL UNIQA in 10 years: In 2003, SIGAL had a capital of 2 million euros and a premium volume of around 8 million euros. Ten years later, SIGAL UNIQA has over 26 million euros of its own capital and premiums of more than 39 million euros. In more than 10 years, SIGAL has maintained its position as a market leader, possessing on average 30% of the market. That has been the case at the time when the market was made up of only five companies and today, with 12 insurance companies operating in Albania.About AAEF: The Albanian-American Enterprise Fund was established at the initiative and decision of the U.S. Congress in 1995 in the framework of Democracies of Eastern Europe Program. The main purpose of AAEF is to promote private sector development by investing or lending in a wide range of private enterprises through the provision of guidance and advice regarding management. AAEF is managed by professional investment managers who are guided by a Board of Directors who are appointed by the U.S. President. About SIGAL UNIQA Group Austria: SIGAL UNIQA Group was listed again this year as one of the 100 largest companies in South-Eastern Europe. As a group of companies consisting of seven insurance companies and one private pension fund, SIGAL UNIQA offers all types of life insurance, non-life, reinsurance and private pensions with more than about 500,000 customers. Since 2002, SIGAL UNIQA is the market leader for insurance claims paid as well as the volume of premiums. Over the years SIGAL UNIQA has won awards at the international level by various institutions, such as Business Initiative Directions, South-East Europe News, Finance Central Europe, etc.

Abraham Lincoln Foundation

The Abraham Lincoln Foundation is known as the premier language center in Albania, having trained more than 50,000 students and professionals since 1998.

We are now launching corporate training for progressive Albanian businesses and professionals. We advocate a metrics based approach to management with an emphasis on soft skills, strategy and leadership. This methodology has produced results for companies by allowing an organization to focus on achieving desired outcomes, developing employee capacity and responsibility, continuously monitoring progress, and anticipating and managing risk.

The Abraham Lincoln Foundation provides this training in collaboration with, FGT, an established Canadian company that has trained more than 20,000 people in Canada, Europe, United States and the Caribbean.We are focused on the following disciplines: soft skills, strategy and leadership, project management, and team management. Our soft skills trainings are offered to professionals and corporations alike. We have designed courses for professional, advanced students of the English language,





# Lajme Anëtarësh

Sigal

Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve (F.SH.A.N) është investitori i parë i huaj që hyri në tregun shqiptar të sigurimeve në një kohë kur tregu ishte i sapo-formuar dhe ende në hapat e tij të parë, 10 vjet më parë. Marrëveshja e bashkëpunimit të cilën F.SH.A.N dhe SIGAL nënshkruan dhjetë vjet më parë shënoi një arritje të rëndësishme për të gjithë tregun e sigurimeve dhe jo vetëm për SIGAL për të cilin F.SH.A.N u bë aksioner. Me rastin e 10-vjetorit të kësaj marrëveshjeje, Bordi i F.SH.A.N zhvilloi ditën e djeshme një takim dhe konferencë për shtyp në zyrat e SIGAL UNIQA.

Në përshëndetjen e tij, Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Avni Ponari, falënderoi F.SH.A.N për mbështetjen dhe besimin e treguar si dhe u ndal në disa nga arritjet e SIGAL UNIQA përgjatë 10 viteve.

Falë mbështetjes së F.SH.A.N, SIGAL u shndërrua nga një kompani lokale në grupin më të madh rajonal të sigurimeve të përbërë nga 8 kompani. Performanca shumë e mirë financiare dhe suporti i FSHAN mundësuan hyrjen e një tjetër investitori strategjik në fushën e sigurimeve në vitin 2007 përmes bashkëpunimit me UNIQA Group AUSTRIA i cili është aktualisht aksioneri më i madh i SIGAL UNIQA. UNIQA Group Austria është një prej kompanive më të fuqishme financiare në Europën Qendrore-Lindore, e vlerësuar me 'A' nga 'Standard&Poor's' dhe prezente në 21 shtete. Pjesë e programit së UNIQA-s dhe sfida për të ardhmen e afërt është investimi në sektorë të tjerë strategjikë në Shqipëri, krahas sigurimeve.

Në fjalën e tij, Presidenti i F.SH.A.N Michael Granoff, ndër të tjera,u shpreh:

"Ne jemi krenarë që jemi pjesë e kësaj kompanie dhe e këtij partneriteti. Ky investim i yni është një histori suksesi pasi ne kemi hyrë në tregun e sigurimeve për ta ndryshuar atë dhe në 10 vjet SIGAL e ka arritur. Shembulli flet vetë pasi nga disa zyra janë shndërruar në qindra dhe nga disa punonjës tani janë disa mijëra. Së bashku me SIGAL kemi dhënë kontributin për të zhvilluar sektorin e sigurimeve. SIGAL synynon që të transformohet në një kompani udhëheqëse edhe në rajon kjo sepse tregu i sigurimeve është një treg me potencial të jashtëzakonshëm."

Në sajë të investimeve të UNIQA dhe F.SH.A.N, dy partnerë të rëndësishëm strategjikë, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ka krijuar më shume besim e garanci për klientët dhe tregun e sigurimeve në tërësi, jo vetëm në Shqipëri por në të gjithë rajonin duke synuar ti japë vendin e merituar industrisë së sigurimeve si një prej 3 shtyllave kryesore të zhvillimit të çdo vendi. SIGAL UNIQA në 10 vjet Në vitin 2003, SIGAL kishte një kapital prej 2 milionë Euro dhe një volum primesh prej rreth 8 milionë Euro. 10 vjet më pas, SIGAL UNIQA ka mbi 26 Milionë Euro kapitale të vetat dhe mbi 39 Milionë Euro prime. Përgjatë 10 viteve SIGAL ka ruajtur pozicionin si lider i tregut duke zotëruar mesatarisht 30% të tregut, si kur në treg operonin vetëm 5 kompani ashtu edhe sot kur ushtrojnë aktivitetin 12 kompani sigurimi. Rreth FSHAN Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve është themeluar me iniciativë dhe vendim të Kongresit Amerikan në vitin 1995 në kuadër të marrëveshjes "Për Demokracitë e Europës Lindore". Qëllimi kryesor i F.SH.A.N është të promovojë zhvillimin e sektorit privat duke investuar ose dhënë hua një game të gjerë sipërmarrjesh private përmes dhënies së udhëzimeve dhe këshillave lidhur me menaxhimin. F.SH.A.N drejtohet nga menaxherë profesionistë të investimeve të cilët udhëhiqen nga Bordi i Drejtorëve të cilët emërohen nga Presidenti i SH.B.A. Rreth SIGAL UNIQA Group Austria SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, u shpall sërish këtë vit si një ndër 100 kompanitë më të mëdha të Europës Jug-Lindore. Si një grup kompanish i përbërë nga 7 kompani sigurimi dhe 1 fond pensionesh private, SIGAL UNIQA ofron të gjitha llojet e sigurimeve të jetës, jo-jetës, risigurime dhe pensione private më shumë se rreth 500,000 klientëve. Që prej vitit 2002, SIGAL UNIQA është lider i tregut të sigurimeve si për dëmet e paguara ashtu edhe për volumin e primeve. Përgjatë viteve SIGAL UNIQA është vlerësuar në nivel ndërkombëtar nga institucione të ndryshme si Bussiness Initiative Directions, South-East Europe News, Finance Central Europe et

Fondacioni Abraham Linkoln

Fondacioni Abraham Linkoln është një nga qendrat kryesore të mësimit të gjuhëve në Shqipëri, duke përgatitur më shumë se 50,000 studentë dhe profesionistë që prej vitit 1997.

Së fundmi, kemi nxjerrë në treg trajnimet për korporatat për zhvillim të mëtejshëm të bizneseve dhe profesionistëve në Shqipëri. Ne përkrahim përqasjen e menaxhimit të bazuar në matjen e rezultateve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë Soft Skills, Strategjisë (Strategy) dhe Udhëheqjes (Leadership). Kjo metodë ka prodhuar rezultate të kënaqshme për kompanitë duke i lejuar të fokusohen në arritjen e të ardhurave të dëshiruara, në zhvillimin e kapacitetit dhe përgjegjësisë së punonjësve, mbikqyrjen e vazhdueshme të këshillimit (mentoring), si dhe parashikimin dhe menaxhimin e riskut.

Ne jemi të fokusuar në disiplinat që vijojnë: soft skills, strategji, menaxhim projektesh (project management) dhe menaxhim ekipi (team management).

Trajnimet tona për soft skills u ofrohen profesionistëve dhe korporatave. Janë të dizenjuara për studentë dhe profesionistë me aftësi të avancuara të gjuhës angleze, të cilët janë të interesuar të mësojnë shprehi, të përmirësojnë shkrimin profesional, si dhe t'u japin jetë aftësive prezantuese.

Ndërsa përkrahim korporatat me trajnime strategjike, ne ndërtojmë udhëheqës që mund të analizojnë orientimin e organizatës së tyre, në mënyrë që të jenë konkurrues. Përmes kurseve të menaxhimit, ne ndihmojmë menaxherët të përmirësojnë aftësitë bindëse, motivuese, mobilizuese dhe negociuese me ekipet e tyre, për të arritur rezultatet e kërkuara.

# Member News

who want to learn idiom, improve the conciseness and clarity of their writing, and energize their presentation skills. As we support corporations with strategic training, we build leaders who can analyze the orientation of their organization in order to obtain a competitive advantage. Through our management courses, we help managers improve their ability to convince, persuade, motivate, mobilize and negotiate with their teams, to achieve specified results.

FGT's expert consultant-trainers have extensive experience in the classroom as well as within various industries such as telecom, finance, and manufacturing. As excellent speakers and facilitators with a unique pedagogical approach and precise vocabulary, workshops always reflect "real life." Most importantly, immediate application of your learning experience is ensured to produce desired results for your business.The Abraham Lincoln Foundation and FGT team are dedicated to meeting your company's strategic demands. The practical and active experience of our instructors will guide you, your team and your organization to exceed expected results through training services, executive coaching or direct consultation with your company. Continuing our tradition of excellence, we are committed to bringing quality and customer satisfaction to our corporate clients.

PwC

PwC will invest $60 million in Central and Eastern Europe (CEE) over the next three years, to enhance industry and specialist expertise and strengthen its lead in the market. The investment will be funded by PwC UK and will focus mainly on bringing in leading talent from the market as well as seconding specialist partners and directors from PwC's global network.

Michael Kubena, CEO of PwC CEE commented on the motivation behind the investment:"As our markets mature, our clients are demanding more from us, and we will need to bring more to the table if we want to retain and build on our number one market position. We need to bring broader, deeper and better integrated offerings that address their unique challenges. We began expanding our range of industry and technical capabilities several years ago, and have already had considerable success. Working more closely with our UK firm will allow us to accelerate investment in our business and more rapidly develop new skills and value propositions that will benefit our clients and drive sustainable profitable growth. At the same time, it will enable us to offer interesting career development opportunities for our people in CEE."

According to PwC's Global Annual Review, there are five global megatrends that will transform the future of business around the world. One of these megatrends is the shift in the global balance of economic power from developed to developing countries. The next decade will see this rebalancing reach a tipping point, as emerging markets expand their global reach and influence still further. In 2009, the total gross domestic product (GDP) of the E7 – the world's seven leading emerging nations – was about two-thirds that of the G7, their developed counterparts. By 2050 these positions will be reversed, with the E7's aggregate GDP rising to almost double that of the G7.Ian Powell, Chairman and Senior Partner of PwC UK, commented: "We are investing in our international network where there is significant potential for higher growth. It is critical that we are well positioned to help our clients benefit from fast developing economies and to work with new clients as they grow."The funding will centre on the industries, geographies and services which are likely to drive economic growth in the region – particularly the larger markets, such as Russia and Poland, as well as high growth economies, and key sectors including oil and gas, utilities, mining, financial services and the public sector.

PwC Albania Country Managing Partner, Paul Tobin, commented that "with the recent economic and political developments in Albania this investment will ensure we will have even stronger capabilities and resources to invest in bringing the fullest range of skills and experience from the PwC network to our clients and future investors in Albania. Our combination of international and Albanian expertise will continue to be fundamental to the high quality of advice and assistance we offer".

About PwC CEE: PwC Central and Eastern Europe been active in the region for more than 20 years. Today, the firm consists of 280 partners and 7,000 staff in 54 offices across 29 countries. We are the only professional services firm to have a fully integrated network spanning Central and Eastern Europe and former CIS countries. About PwC UK: PwC UK employs 874 partners and over 17,400 people in 57 offices across the UK, Channel Islands and the Middle East. About PwC: PwC helps organisations and individuals create the value they're looking for. We're a network of firms in 157 countries with more than 184,000 people who are committed to delivering quality in assurance, tax and advisory services.





# Lajme Anëtarësh

Fondacioni Abraham Linkoln i ofron këto trajnime në bashkëpunim me FGT, një kompani e themeluar në Kanada, e cila ka trajnuar më tepër se 20,000 individë në Kanada, Evropë, Shtetet e Bashkuara dhe Karaibe.

Ekspertët këshillues dhe trajnues të FGT-së kanë një eksperiencë të gjatë në mësimdhënie dhe në fusha të ndryshme të industrisë, si në telekom, financë dhe në prodhim. Si folësa të shkëlqyer dhe me eksperiencë, me një përqasje të veçantë pedagogjike dhe fjalor të saktë, seancat e tyre mësimore (workshops) reflektojnë gjithmonë "jetën e përditshme". Për më tepër, sigurohet praktikimi i menjëhershëm i kësaj eksperience, për të prodhuar rezultatet e dëshiruara për biznesin tuaj.

Fondacioni Abraham Linkoln dhe ekipi i FGT-së janë të përkushtuar për të arritur kërkesat strategjike të kompanisë tuaj. Eksperienca aktive dhe praktike e instruktorëve tanë do t'ju udhëheqë ju, ekipin dhe organizatën tuaj të tejkaloni rezultatet e pritura përmes trajnimeve, apo konsultimit me grupin drejtues dhe keshillime drejtpërsëdrejti me kompaninë tuaj.

Duke vazhduar traditën e shërbimit të shkëlqyer, ne jemi të përkushtuar të ofrojmë cilësi dhe përmbushje të detyrimit ndaj klientëve tanë të korporatave.

PricewaterhouseCoopers (PwC)

PricewaterhouseCoopers (PwC) do të investojë 60 milionë dollarë amerikanë në Evropën Qëndrore dhe Lindore në tre vitet e ardhëshme, për të rritur nivelin e ekspertizës në industri dhe për të forcuar pozicionin drejtues në treg. Investimi do të financohet nga PwC në Mbretërinë e Bashkuar dhe do të përqëndrohet kryesisht në prurjen e talenteve nga tregu vendas dhe partnerëve e drejtuesve të specializuar nga rrjeti global i PwC.

Michael Kubena, CEO për PwC në Evropën Qendrore dhe Lindore, duke komentuar mbi motivin që çoi në këtë investim shprehet:"Me rritjen e tregjeve tona, rriten gjithashtu edhe kërkesat e klientëve tanë dhe ne do të na duhet të ofrojmë më shumë nëse duhet të mbajmë dhe të forcojmë pozicionin tonë si më të mirët në treg. Ne duhet të ofrojmë një gamë më të gjerë, më të thelluar dhe më të integruar shërbimesh që iu përgjigjen nevojave dhe vështirësive specifike të klientëve. Para disa vitesh ne nisëm me zgjerimin e aftësive teknike dhe ia dolëm me sukses. Duke punuar më afër me PwC në Mbretërinë e Bashkuar do të bëhet i mundur përshpejtimi i investimeve në biznesin tonë. Në të njëjtën kohë, do të bëhet gjithashtu i mundur ofrimi i opsioneve interesante të zhvillimit të karrierës së punonjësve tanë në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore."

Sipas Raportit Vjetor Global të PwC, një ndër pesë prirjet kryesore që do të transformojnë të ardhmen e biznesit në botë, është zhvendosja e ekuilibrit global të fuqisë ekonomike nga vendet e zhvilluara tek vendet në zhvillim. Dekada e ardhëshme do të shënojë pikën kulmore të kësaj zhvendosjeje ndërkohë që tregjet në rritje zgjerohen dhe shtojnë ndikimin e tyre në botë. Në vitin 2009, produkti i përgjithshëm bruto (PBB) i vendeve E7 – shtatë vendeve me zhvillimin ekonomik të shpejtë – ishte sa afro dy të tretat e G7- vendeve më të zhvilluara në botë. Në vitin 2050 do të kemi një zhvendosje të ketyre pozicioneve ku totali i PBB-së së vendeve E7 do të jetë sa dyfishi i atij të vendeve G7.

Ian Powell, kryetar bordi dhe partner i PwC në Mbretërinë e Bashkuar, shprehet: "Ne po investojmë në rrjetin tonë ndërkombëtar aty ku ka një potencial të dukshëm për rritje të mëtejshme. Është shumë e rëndësishme që të qëndrojmë në pozitat e duhura për të ndihmuar klientët në mënyrë që ata të përfitojnë nga ekononomitë me zhvillim të shpejtë si dhe të punojmë me klientët tanë të rinj në procesin e rritjes dhe zhvillimit të tyre.

Financimi do të përqendrohet në industritë, vendet dhe shërbimet të cilat mundësojnë rritje ekonomike në rajon– në veçanti tregjet më të mëdha si Rusia dhe Polonia si edhe ekonomitë me rritje të madhe dhe sektorët kyç si ato të naftës dhe gazit, energjisë, minierave, shërbimeve financiare dhe sektorit publik.

Paul Tobin, Partneri Drejtues për PwC në Shqipëri, komenton:"me zhvillimet më të fundit ekonomike dhe politike në Shqipëri, ky investim do të forcojë edhe më shumë burimet tona dhe do të bëjë të mundur ofrimin e ekspertizës dhe përvojave më të mira nga rrjeti i PwC për klientët tanë dhe investitorët e ardhshëm në Shqipëri.

Kombinimi i ekspertizës sonë ndërkombëtare me atë vendase do të vazhdojë të jetë thelbësor në ofrimin e shërbimeve tona me një cilësi të lartë".

PwC në Evropën Qendrore dhe Lindore: PwC ushtron aktivitet në Europën Qendrore dhe Lindore për më shumë se 20 vjet. Aktualisht, numërohen 280 partnerë dhe 7,000 punonjës në 54 zyra në 29 vende të rajonit. PwC është firma e vetme e shërbimeve profesionale të konsulencës me një rrjet të integruar plotësisht në Evropën Qendrore dhe Lindore. PwC në Mbretërinë e Bashkuar: PwC në Mbretërinë e Bashkuar ka afro 874 partnerë dhe mbi 17,400 punonjës në 57 zyra në Mbretërinë e Bashkuar, Channel Islands dhe Lindjen e Mesme. Për më shumë informacion mund të vizitoni faqen zyrtare. PwC ndihmon organizatat dhe individët të krijojnë vlerat e dëshiruara. Me një shtrije në 157 vende dhe me një staf prej më shumë se 184,000 punonjësish, PwC është një rrjet firmash që ofron shërbime cilësore në fushën e auditimit, konsulencës fiskale dhe asaj financiare.

# CHALLENGES for recyclers

## *From waste to new products, how the recycling industry works*

**Plastic bags, bottles and packaging commonly found carelessly thrown on Albania's streets or dumped near residential areas – or even worse – in tourist areas -- have been for years a challenge for local governments.**

Recycling these waste products with new technologies applied today in developed countries is an effective and long-term solution that guarantees the preservation of the environment, conserves natural resources, increases economic development and helps solve social problems through providing jobs and self-employment.

Polyethylene and plastic bottles across the country are collected and processed to become plastic packaging for shipping, garbage bags, bags for the construction industry, food processing packaging, agricultural plastic sheets etc. Everest I.E. does all of this using the latest modern technologies for recycling waste that has been separated at the source.



"We have provided jobs for 150 employees that work at the plant and about 1,000 self-employed people that collect waste across the country and provide us with raw material for 40 percent of our production," says Vullnet Haka, administrator at Everest IE, a recycling company and an AmCham member. For some time now, the recycling industry has had a hard time getting the amount of raw recyclable materials it can process due to the fact that local governments are not implementing the law on integrated waste management which ensures separation of recyclable waste at the source.

In addition, Everest and many other recycling companies are faced with a new government decision that prohibits the import of waste, which takes away the opportunity to supply their production with raw material that was until recently imported.





# SFIDA e ricikluesve



## *Nga mbetje në produkte, si do të zhvillohet industria ricikluese*

**Qeset, shishet plastike dhe ambalazhet e ndryshme pas përdorimit të tyre ,të cilat i gjejmë të hedhura pa kujdes në rrugë ,apo të grumbulluara jashtë çdo kontrolli pranë zonave të banuara dhe akoma më keq në zona turistike ,kanë përbërë prej vitesh sfidën e pafituar të qeverive lokale.**

Por, duket se riciklimi i këtyre mbetjeve me teknologjitë më të reja që zbatohen sot në vendet e zhvilluara është zgjidhja më efektive dhe afatgjatë, që garanton ruajtjen e mjedisit,ruajtjen e burimeve natyrore,zhvillim ekonomik,si dhe zbut dukshëm problemet sociale tek shtresat më në nevojë duke i punësuar,apo duke iu mundesuar vetëpunesim.

Mbledhja dhe grumbullimi i ambalazheve prej polietileni dhe shive plastike në të gjithë vendin rikthimi i tyre në ambalazhe plastike si qese për shipping, qese për mbeturina, thasë për industrinë e ndërtimit, agropërpunimit, fletë plastike për bujqësinë etj,i ka kërkuar kompanisë Everest I.E aplikimin e një prej teknologjive më avangardë të riciklimit dhe riprodhimit prej mbetjeve urbane të ndara në burim."Kemi futur në punë 150 punonjës vetëm në fabrikë dhe rreth 1.000 të vetëpunësuar në mbledhjen dhe grumbullimin e mbetjeve në të gjithë vendin dhe na japin një mundesi të sigurojmë lëndën e parë për 40 % të prodhimit" – thotë Vullnet Haka administratori i kompanisë së riciklimit "Everest I.E" anëtar i Dhomës Amerikane të Tregëtisë.

Prej kohësh kjo industri vuan per të siguruar lëndën e saj të parë brenda vitit,për shkak se pushteti lokal nuk po implementon ligjin për menaxhimin e integruar të mbetjeve i cili siguron ndarjen në burim të mbetjeve të ricikIueshme.

Përballë kësaj situate Everest shpk dhe shumë kompani të tjera ricikluese u përballën edhe me miratimin e ligjit që ndalon importin e mbetjeve duke mos patur mundësi të furnizojnë prodhimin e tyre me

The recyclers' association lobbied the Parliamentary Commission for Production and Industry on the issue, explaining and arguing that they have a need to import waste products even if it a very small percentage. The initiative of the recyclers' association also had the support of the American Chamber of Commerce in Albania. AmCham explained through its representative in the parliamentary committee that in its opinion the ban on the import of waste in order to use domestic waste for recycling should still allow a small amount of imports to come in order to develop the industry in the long term.

The view is supported by the recyclers' own argument that people bring recyclers that based on population and the amount of waste produced each day and taking into account that over 70% the waste is recyclable if separated at the source, the current recycling industry will have to increase its capacity several times.

Under these conditions, the industry would need to import only small quantities of recyclable waste that are not found inside Albania and mainly to improve the quality of products produced by recycling waste that is found domestically.



## AmCham's stance in connection to recycling of urban waste

The American Chamber of Commerce supports every mechanism which promotes a clean, natural environment and an effective management of waste in Albania. The American Chamber of Commerce views the recycling industry as closely related to government efforts for a cleaner Albania and the development of the recycling industry can contribute to a more efficient waste management system in the country.

However, for the industry to continue to operate, it is indispensable for them to import some high-grade recycled or raw materials which cannot be found or produced in Albania. This high-grade material serves as a key component and catalyzer for the recycling process, or otherwise the industrial process simply cannot happen.

The Recycling Association of Albania represents 60 companies in the recycling industry. Collectively, they have invested approximately 120 million Euros in Albania and have a yearly turnover of more than 200 million Euros. While some goods are sold on the local market, the majority of recycled products are exported. The industry directly employs more than 1200 Albanians and almost 39.000 people are self-employed in the industry as gatherers of recyclable material.

For this reason, the American Chamber of Commerce hoped some accommodation for the recycling industry can be found, which in parallel with a better waste management and recycling sector, will serve to enhance Albania's environment and the quality of life for its citizens.





atë pjesë së lëndës së parë që deri dje e importonin. Shoqata e ricikluesve loboi në komisionin Parlamentar të Prodhimit dhe Industrisë për të shpejguar dhe argumentuar nevojën e importit të këtyre mbetjeve qoftë dhe në një përqindje shumë të vogël. Në këtë inisiativë të tyre, Shoqata e ricikluesve u përkrah edhe nga Dhoma Amerikane e Tregtisë. Amcham sqaroi nëpërmjet Drejtores ekzekutive Floreta luli-Faber, në Komisionin Parlamentar mendimin e organiztaës për të ndaluar importin e mbetjeve në mënyrë që të përdoren burimet e brendshme por lejimin në një masë të vogël të importit për nevojat e zhvillimit të kësaj industrie në planin afatgjatë. Ky qëndrim mbështetet nga argumenti që sjellin vetë ricikluesit se mbështetur në numrin e popullsisë dhe sasinë e mbetje që prodhohet çdo ditë dhe duke mbajtur në konsideratë që mbi 70% e tyre janë të ricikueshme nëse do të ndahen në burim,industrise aktuale të ricikimit do t'i duhej të rriste disa herë kapacitetej e saja të përpunimit. Në këto kushte kjo industri do të kishte nevojë të importonte vetem sasira të vogla mbetjesh të ricikueshme të tipologjive që nuk gjenden në vendin tonë dhe kryeshisht për të përmirësuar cilësinë e produkteve që prodhohen nga riciklimi i mbetjeve qe mblidhem brenda vendit.

## Qëndrimi i Dhomës Amerikane në lidhje me riciklimin e mbetjeve urbane

Dhoma Amerikane e Tregtisë mbështet çdo mekanizëm, i cili promovon një mjedis të pastër dhe natyral si dhe një menaxhim sa më efikas të mbetjeve në Shqipëri. AmCham e shikon industrinë e riciklimit si të lidhur ngushtë me përpjekjet e qeverisë për një Shqipëri më të pastër dhe se zhvillimi i kësaj industrie mund të kontribuojë në një sistem menaxhimi më efikas të mbetjeve në vend.

